

Invaliditeti

Kush për kohë të gjatë nuk mund të punojë për arsye shëndetësore apo mund të punojë vetëm pjesërisht, ka sipas rrethanave të drejtën për mbështetje financiare përmes sigurimit të invaliditetit (IV). IV nuk paguan vetëm para. Ai i mbështet të siguruarit para së gjithash te hyrja apo rihyrja në punë.

Sigurimi i invaliditetit

Sigurimi i invaliditetit (IV) është institucion i shtetit. Shumica e personave të rritur duhet të paguajnë kontribute për këtë. Kontributet zbriten tek të punësuarit çdo muaj prej rrogës, punëdhënësi merr përsipër gjysmën. Të vetëpunësuarit apo personat pa vend pune duhet të pyesin te arka e balancimeve (Ausgleichskasse), se si duhet t'i paguajnë kontributet e tyre.

Mbështetja përmes sigurimit të invaliditetit

Të drejtë për mbështetje nga IV kanë personat, që për arsye shëndetësore (psikike apo fizike) gjatë paktën një viti nuk kanë punuar fare apo vetëm pjesërisht. IV paguan mbështetjen në formën e një pensioni mujor. Mirëpo kjo bëhet vetëm atëherë, kur të siguruarit për shkak të kufizimeve të tyre nuk mund të riaftësohen më për punë. IV mbështet personat invalid, që të gjejnë një punë të përshtatshme. Për mbështetjet përmes IV duhet të aplikohet te arka e balancimeve (Ausgleichskasse).

Shërbimet shtesë

Personat, të cilët me gjithë mbështetjen nga IV kanë pak para për të jetuar, kanë sipas rrethanave të drejtën për përfitime plotësuese financiare (Ergänzungsleistungen). Për ta aplikimi duhet të bëhet në entin për kontribute sociale. Është rregulluar qartazi, se kush e gëzon të drejtën për përfitime plotësuese. Përfitimet plotësuese financohen nga tatimpagueset dhe tatimpaguesit.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/siguria-sociale/invaliditeti